

20090480842

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007 dhe 88/2008) në nenin 3 pika 5) në nënpikën a) fjalët: "mund të ndikojnë direkt ose indirekt" zëvendësohen me fjalët: "mund të ketë kontroll direkt ose indirekt".

Në nënpikën b) fjalët: "mund të ndikojnë direkt ose indirekt", zëvendësohen me fjalët: "mund të ketë kontroll direkt ose indirekt".

Në nënpikën g) fjalët: "ose persona" zëvendësohen me fjalët: "ose person juridik".

Pas pikës 5 shtohet pikë e re 5-a si vijon:

"5-a) "Kontrolli" në kuptim të pikës 5 të këtij neni është kur një person:

a) direkt ose indirekt posedon depozitën shumicë në person tjetër juridik; ose
b) direkt ose indirekt posedon shumicën e të drejtave të votës në person tjetër juridik; ose
v) ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë shumicën e anëtarëve të organeve për administrim të personit tjetër juridik, direkt ose indirekt, duke lidhur kontratë me një ose më tepër aksionarë të personit tjetër juridik për kalimin ose bashkimin e të drejtave të tyre të votës me qëllim të krijimit të interesave të përbashkëta; ose

g) ka të drejtë të realizojë, direkt ose indirekt, ndikim të konsiderueshëm mbi administrimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste të personit tjetër juridik."

Neni 2

Në nenin 16 pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7) si vijon:

"(7) Agjencia së afërmi e rregullon mënyrën e lidhjes dhe bashkimit të shoqërive për administrim me fonde të detyrueshme pensionale."

Neni 3

Në nenin 20 paragrafi (1) pika v) fjalët: "lidhje të kontratave për" zëvendësohen me fjalën "marrje".

Neni 4

Në nenin 22 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Agjencia e përcakton përmbajtjen e revizionit të jashtëm të shoqërive pensionale në pajtim me standardet ndërkombëtare."

Neni 5

Neni 39-zh ndryshon si vijon:

"(1) Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personat përgjegjës ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të të dhënave të shënuara në nenin 39-v të këtij ligji, i nënshtrohen lejes paraprake nga ana e Agjencisë, përveç nëse ndryshimet janë jashtë kontrollit të shoqërisë, kurse i i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e ndryshimeve. Për ndryshimet e krijuara jashtë kontrollit të shoqërisë, ajo është e obliguar ta njoftojnë Agjencinë.

(2) Agjencia i vlerëson ndryshimet nga paragrafi (1) të këtij neni në pajtim me dispozitat për plotësimin e kushteve nga neni 39-g të këtij ligji."

Neni 6

Në nenin 39-z paragrafi (1) fjalët: ”dhe 143 paragrafi (4)” shlyhen.

Neni 7

Në nenin 47 paragrafi (1) pika a) në rreshtin e gjashtë pas fjalës ”lëshon” dhe presja shtohen fjalët: “tërheq ose pezulloj”

Në pikën zh) pas fjalës “agjentë” shtohen fjalët: “dhe regjistri i anëtarëve”.

Pas pikës x) shtohen dy pika të reja i) dhe j) si vijon:

“i) i përpunon të dhënat personale në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale;

j) kërkon dhe jep të dhëna personale për shfrytëzim në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.”

Pikat i), j), k), ll) dhe l) bëhen pika k), ll), l), m), dhe n).

Neni 8

Në nenin 53 paragrafi (5) fjala “parregullsi” zëvendësohet me fjalën ”paligjshmëri”, fjala “shoqëri” zëvendësohet me fjalët: ”shoqëria pensionale”.

Neni 9

Në nenin 54 paragrafi (2) fjalia e dytë ndryshon si vijon: “Pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë raporti i dorëzohet për informim Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.”

Neni 10

Në nenin 56 paragrafi (3) fjala “shoqëri” zëvendësohet me fjalët: ”shoqëria pensionale”.

Pika d) ndryshon si vijon:

d) “kompensim për trajnimin dhe organizimin e provimit”.

Neni 11

Në nenin 75 paragrafi (3) në pikën v) pas fjalës “shoqëritë” shtohen fjalët: “edhe shoqëritë për administrim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Neni 12

Në nenin 83 paragrafi (3), 106 paragrafi (1) dhe (2) dhe 108 paragrafi (1) pika e) fjalët: “pas mendimit paraprak nga Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë” shlyhen.

Neni 13

Në nenin 92 shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Blerja e anuitetit pensional dhe pagesa e mjeteve të akumuluar në pajtim me paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni mund të bëhet pas moshës 65 vjeçare të jetës.”

Neni 14

Në nenin 94 paragrafi (3) fjalët: ”në formë të broshurës” shlyhen.

Neni 15

Në nenin 96 paragrafi (1) dhe 98 paragrafi (1) pas fjalës “shoqëria” shtohen fjalët: “dhe shoqëria për administrim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare”.

Neni 16

Në nenin 105 paragrafi (1) në pikat x),i) dhe j) fjalët: “Japonia ose SHBA” zëvendësohen me fjalët: “vendet anëtare të OECD”.

Në pikën k) fjalët: “Japonia ose SHBA” zëvendësohen me fjalët: “vendet anëtare të OECD-së, ndërsa në rreshtin e katërt fjala “aksione” zëvendësohet me fjalët: “letra me vlerë”.

Paragrafi (4) shlyhet.

Neni 17

Në nenin 106 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Agjencia e përcakton shumën më të lartë të investimeve në instrumente nga i njëjti grup ekonomik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë, vendet anëtare të Unionit Evropian ose vendet anëtare të OECD”.

Paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (4), (5), (6) dhe (7).

Neni 18

Në nenin 107 paragrafi (1) pika a) numri “20%” zëvendësohet me numrin “30%” ndërsa numri “10%” me numrin “20%”.

Neni 19

Në nenin 108 pas pikës d) shtohet pikë e re gj) si vijon:

“gj) “depozitat bankare në bankat të cilat janë aksionarë të shoqërisë ose të shoqërisë për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;”

Pikat gj) dhe e) bëhen pika e) dhe zh).

Neni 20

Në nenin 109 në paragrafin (1) shtohet fjali e re si vijon:

“Shoqëria Agjencisë i paraqet raporte mujore për masat e ndërmarra për harmonizimin e aktiviteteve investuese.”

Paragrafi (4) ndryshon si vijon:

“Me kërkesën e shoqërisë ose shoqëri për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, të parashtruar në afat prej së paku 60 ditësh para datës së skadimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia ka të drejtë ta vazhdojë afatin nga paragrafi (3) i këtij neni më së shumti për gjashtë muaj, nëse ky vazhdim është i domosdoshëm për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të fondit pensional të detyrueshëm.”

Neni 21

Pas nenit 112 shtohet neni i ri 112-a si vijon:

“Neni 112-a

(1) Çdo shoqëri e cila administron me fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar duhet të ketë dokument për strategji investuese dhe të kryejë revidimin e saj së paku në çdo tre vjet.

(2) Dokumenti për strategjinë investuese veçanërisht duhet të përmbajë metoda për matjen e rrezikut investues, proceseve për administrim me rrezikun dhe shpërndarjen strategjike të mjeteve.

(3) Agjencia për së afërmi e rregullon përmbajtjen e strategjisë investuese.”

Neni 22

Në nenin 133 paragrafi (3) në pikën 9 fjalët: “neni 39-e” zëvendësohen me fjalët: “neni 39-zh”.

Neni 23

Në nenin 134 paragrafi (1) në pikën 15 fjalët: “investon mjete nga fondi pensional i detyrueshëm” zëvendësohen me fjalën “vepron”.

Neni 24

Neni 139-a shlyhet.

Neni 25

Rojtar i pronës së fondit pensional të detyrueshëm me të cilin administron një shoqëri ose shoqëri për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare të themeluar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë.

Në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji shoqëritë nga paragrafi 1 të këtij neni duhet të zgjedhin rojtar të pronës së fondit pensional të detyrueshëm në pajtim me nenin 115 dhe 116 nga Ligji për sigurimin të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007 dhe 88/2008).

Deri në zgjedhjen e rojtarit të pronës nga paragrafi 2 i këtij neni, shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare e njofton Agjencinë për instrumentet në të cilat planifikon t'i inestojë mjetet e fondit pensional të detyrueshëm me të cilin administron.

Agjencia vazhdon të mbajë evidencën e instrumenteve financiare të lejuara për investimin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme deri në bartjen e rolit të rojtarit të pronës nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në bankë.

Neni 26

Neni 19 i këtij ligji nuk ka të bëjë me depozitat bankare të investuara në banka deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Neni 27 paragrafi 2 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 88/2008) shlyhet.

Neni 28

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ta verifikojë tekstin e spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".